

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË**, Departamenti i Përgjithshëm, si civile, në trupin gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Shala , kryetar dhe gjyqtaret porotë Kimete Fejza dhe Sebiha Smakiqi, ne çështjen juridike të paditësit S.M nga Mitrovica , të cilën e përfaqëson avokati I.H nga Mitrovica sipas autorizimit me shkrim, kundër të paditurës M.M e vajzerise M. nga Mitrovica, tani me vendbanim të panjohur, të cilën e përfaqëson avokat U.G nga Mitrovica, përfaqësues i përkohshëm, sipas aktvendimit te kesaj gjykate, në seancën e mbajtur me dt 09.03.2017, bie:

## **A K T G J Y K I M**

Martesa ne mes te paditesit S.M nga Mitrovica i lindur me dt. 04.05.1972 ne fsh. R. Komuna e Vushtrrise, nga i ati S., e ema Sh., i vajzerise D. dhe M.M e vajzerise M nga Mitrovica e lindur me dt... ne Mitrovice, nga babai Q. , e ema H. i vajzerise A., e lidhur ne Zyren e gjendjes civile ne Mitrovice me dt. ... me nr. Rend. ... dhe numer te references ..., **ZGJIDHET** per shkak te cregullimit serioz dhe te vazhdueshem te marredhenive martesore ne kuptim te nenit 68 al. 2 dhe nenit 69 al. 2 te Ligjit mbi Familjet te Kosoves .

Secila pale i barte shpenzimet e veta, kurse shpenzimet e perfaqesuesit te perkohshem i barte paditesi.

## **A r s y e t i m**

Paditësi në padi dhe permes te autorizuarit te tij gjatë shqyrtimeve te mbajtura ka theksuar se mbetet ne teresi prane padise dhe kerkespadise duke kerkuar qe martesa te zgjidhet sepse ka interes, sipas te dhenave qe ka paditesi e paditura jeton ne GJ. ne adrese te panjohur per ne dhe se paditesi ka humbur cdo kontakte me te qe nga Marsi 2016, ku edhe faktikisht e kane shkeputur bashkesin martesore duke jetuar faktikisht te ndare. E paditura tani nuk jeton as ne adresen e dhene sic eshte cekur ne cartifikaten e marteses. Te njejtit nga kjo nuk kane femije e as qe pritet te kene. Meqe e paditura jeton ne adres te panjohur per paditesin i propozoje kesaj gjykate qe te njejtës te ia caktoje perfaqesuesin e perkoheshem. Ne seancen e shqyrtimit kryesor i autorizuari i te njejtit ka kerkuar qe martesa te zgjidhet sepse eshte plotesuar kushti i pergjithshem per zgjedhjen e marteses gjegjesisht cregullimi serioz te marredhenive bashkeshorteve si dhe kushti i vecant, nderprerja e paarsueshme e jetes faktike martesore per me shume se nje vit konform dispozites se nenit 69 par.2 te LF.Ne fjalen e tij perfundimtare ka theksuar se Mbetem prane deklarates se dhene ne seancen e sotme i propozoj gjykates qe konform nenit 69 par.1 dhe 2 te LF ,

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoj.

Pasi qe e paditura tani jeton në adresa të pa njohur, ndërsa nuk ka të autorizuar në këtë çështje juridike, në kuptim të nenit 79 pika 2 / b të paditurës iu caktua përfaqësuesi i përkohshëm avokat U.G nga Mitrovica, i cili ka pas për detyre ligjore që të paditurën ta përfaqësoi gjerë në përfundim të plotfuqishëm te këtij kontesti gjithnjë deri sa e paditura apo i autorizuari i saj të paraqitet në këtë gjykatë. Caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm u publikua në gazetën e përditshme “...” e datës ... dhe u afishua

në tabelën e shpalljeve pranë kësaj gjykate. Aktvendimi për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm ju dërgua Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë.

Përfaqësuesi i përkohshëm deklaroi se fillimisht e kundërshton kërkesëpadinë por nuk e kundërshtoi nxjerrjen e provave .Ne fjalën e tij perfundimtare ka theksuar se Mbesim ne teresi prane fjalën se deklaruar ne seancen e sotme. Njikohesisht i propozoj gjykates qe konform dispozitave ligjore dhe kompetences se saj te merr vendim lidhur me kete lend.

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoj per arsye se te njejtat i jane kompenzuar.

Kompetenca e kësaj gjykate për të vendosur në këtë çështje bazohet në dispozitën e nenit 11 pika 1. e Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat i publikuar në gazetën zyrtare të Kosovës Nr 79 datë 24 Gusht 2010 i zbatueshëm prej datës 01.01.2013, ku parashihet se “Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”.

Nga provat shkresore u administruan Certifikata e martese e datës ..., qe dëshmon se palët kanë lidhur kurorë me ..., në Mitrovicë, pran Zyrës së Gjendjes Civile, Aktvendimi për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm C.nr.579/16 te datë 06.02.2017 dhe Publikimin ne te përditshmen epoka e Re e dt. ...

Gjykata i administroi provat e propozuara dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 7 dhe 8 te Ligjit mbi procedurën kontestimore te Kosovës gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe pas shqyrtimit të të njëjtave dhe pas marrjes në pyetje të paditturit, gjeti se martesja për mungesë të bashkëjetesës u konsiderua si e dështuar dhe padia si e ligjshme dhe e lejuar në kuptim të nenit 69 al. 1 të Ligjit mbi Familjen ku parashihet se” *Bashkëshorti mund të kërkojë shkurorezim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyre të vazhdueshme, ose ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit*” .

Mbi shpenzimet procedurale u vendos në kuptim të nenit 347 të Ligjit mbi familjen të Kosovës.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË.**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**C.nr.579/16, datë 09.03.2017.**

**KRYETARI I KOLEGJIT –GJYQTARI**

Skender Shala

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës se Apelit në Prishtinë e përmes kesaj gjykate.